



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 25.09-19 Ref.: 1784/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 77-të të mbajtur më 16.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit të programeve të studimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nga 01.10.2019 deri 30.09.2020.

Fakulteti Ekonomik

- Ekonomiks (gjuhë angleze) PhD, 180 ECTS, maksimum 15 student për vit akademik

Fakulteti Juridik

- E Drejta Penale, PhD, 180 ECTS, maksimum 10 student për vit akademik
- E Drejta Civile, PhD, 180 ECTS, maksimum 10 student për vit akademik
- E Drejta Financiare, PhD, 180 ECTS, maksimum 10 student për vit akademik

- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim


Agjencia e Kosovës për Akreditim është në proces të rishikimit dhe hartimit të politikave dhe standardeve përmes së cilave do të vlerësohen programet e nivelit PhD. Përmes rishikimit të këtyre politikave dhe standardeve, AKA do të sigurohet se vetëm programet të cilat plotësojnë këto kritere do të mund të akreditohen.

Meqenëse Universiteti i Prishtinës ka aplikuar për ri-akreditim të këtyre programeve brenda afatit të paraparë ligjorë, dhe se AKA nuk ka mundur të zhvilloj procedura të vlerësimit në mungesë të standardeve, dhe me qëllim që të sigurohet se nga viti i ardhshëm të gjitha programet e nivelit PhD do t'i nënshtrohen vlerësimit me standardet e rishikuara, Këshilli Shtetëror i Cilësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

